

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këshilli i Sigurisë së Kombit që mblidhet për “radarin” e Gysit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/keshilli-i-sigurise-se-kombit-qe-mblidhet-per-radarin-e-gysit-i588282
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 09:32:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 09:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9e2a5e8bc8ca0299ecd6d9263233e664209de9645c6bfac2a00c87286b2cf1ce
TEKSTI	9f98f18dd29b70f40bbb110d592bfa1de537dcdffbefc4dfc45571ca1eb7b14c
PAMJA	24a0d7c9ed36a63ef1941ea4814db03a3bca4b416881d74b93f6654ca66e8a18

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	620bfb0467d8145feeb7f8d269640788a32da2716e392b37f18a63f537168464
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5232afb02d0ef3cfba4c89fffc05e27ccc8e2122c3335e6361f8bbb2dc579865
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/620bfb0467d8145feeb7f8d269640788a32da2716e392b37f18a63f537168464>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Këshilli i Sigurisë së Kombit që mbledhet për “radarin” e Gysit](#) Ministria i përgjigjet Berishes: “Tek Agasi isha bashkë me Argitën Ylli i Mëneskin dhe artistja Dove Cameron” fundit

Këshilli i Sigurisë së Kombit që mbledhet për “radarin” e Gysit



25 Shtator 2026, 11:28 Blog TEMA



Nga Ylli Manjani

Ka diçka madhështore në mënyrën si ky vend i zgjedh rreziqet kombëtare. Jo lufta. Jo krimi. Jo kufijtë. Jo ekonomia. Jo të dhënat personale që dalin në pazar. Jo institucionet që rrjedhin si sitë.

Jo.

Siguria e kombit nuk ka qenë kurrë kaq e rrezikuar sa sot, kur dolën disa SMS të Gysit me zonjën Vlorë. Alarm maksimal. Gjendje pothuajse lufte. Mblidhni Këshillin e Sigurisë. Ngrini radarët. Njoftoni aleatët. Kombi është nën sulm... sentimental.

Ndërkohë, ky komb paskësh qenë shumë më i sigurt kur i shisnim naftë ushtrisë së Millosheviçit. Ishte i sigurt kur hynim në sherre minoritetesh. Ishte i sigurt kur zgjedhjet fitoheshin me rezultate që edhe matematika refuzonte t'i njihte. Ishte i sigurt kur opozita rrihej se protestonte.

Ishte i sigurt kur u thyen depot e ushtrisë dhe u armatosëm kundër njëri-tjetrit. Kur digjeshin redaksi gazetash. Kur vriteshim “pa dashje”. Kur u çanë kufijtë dhe fundi i Adriatikut u mbush me trupat e bashkëkombasve tanë që iknin nga Shqipëria.

Ishte i sigurt kur ngriheshin barrikada për të hyrë në qytete. Kur vriteshin deputetë. Kur çdo verë lahej ndonjë hesap me plumba. Kur Kosova u pushtua. Kur ekonominë e shkatërronim me dorën tonë. Kur bizneset mbylleshin me urdhër, e privatësia dilte në mejhane, në WhatsApp, në Excel e në televizor.

Kombi ishte super i sigurtë kur shpërtheu Gërdeci.

Asgjë nga këto nuk e tronditi sigurinë kombëtare.

Po ja ku erdhi katastrofa.

Mesazhet e shpirtit të Gysit.

Këtu shteti u kujtua se ka radarë. Madje radarë shumë të ndjeshëm. Kapin puls, emoji, zemra, mall, nostalgji... gjithçka. Për çudi, po këta radarë kanë vite që nuk kapin drogë, korrupsion, rrjedhje informacioni, krim të organizuar apo miliona që avullojnë.

Janë radarë selektivë. Punojnë vetëm në frekuencën e Gysit.

Prandaj urgjent duhet të mblidhet Këshilli i Sigurisë. Të analizojë kërcënimin strategjik që paraqesin allatet e Gysit. Të caktojë nivelin e alarmit sipas lartësisë së tyre nga toka. Sepse ky është standardi i ri i sigurisë kombëtare, dmth jo sa i mbrojtur është shteti, por sa poshtë varen goglat.

Kur vjen puna te to (goglat pra), siguria fik radarët për gjithçka tjetër dhe ndez sirenat.

Rroftë kombi që ka mbijetuar luftëra, rebelime, varfëri, emigrim, korrupsion e tragjedi, por që sot dridhet nga një SMS.

A të rrufsha pallën e sigurisë, o komb!

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Foreign Policy Journal: Reforma në drejtësi e Shqipërisë ka krijuar një pushtet pa llogaridhënie

10:00 Blog / 4 komente

Shërbimi ynë jo inteligjent

22:49 Blog / 21 komente

Vlora Hyseni na tha të gjithëve: "Nuk kam ndër mend ta dorëzoj kokën në sini të ergjëndtë"

21:15 Blog / 17 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.